

**FORMULARI I ANKESËS PRANË AUTORITETIT/ENTIT KONTRAKTOR**  
**DHE**  
**KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK**

Ankesë drejtuar: Autoriteti/Entit Kontraktor: **Spitali Rajonal Vlorë**  
Adresa: **Lagjja "Partizani" Vlorë**



Ankesë drejtuar: **Komisionit të Prokurimit Publik**

**Seksioni I. Identifikimi i ankimuesit**

*Ankimuesi mund të jetë një ofertues ose ofertues i mundshëm (p.sh. individ, operator ekonomik, shoqatë, bashkim operatorësh ekonomike)*

**Seksioni I. Identifikimi i ankimuesit**

**"Distributor of Medical Devices Group" shpk**

Emri i plotë i ankimuesit (ju lutem shtypeni)

**L81422033E**

Nuis/Nipt

**Njesia Nr. 8, Rruga "Siri Kodra", Objekti Nr. 198 - Tiranë**

Adresa

**Tiranë**

**Shqipëri**

Qyteti

Shteti

Kodi Postar / Posta

**+355699892466**

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

**ceo.dmdgroup@gmail.com**

E-mail

**Matteo SHEHU - Administrator**

Emri dhe titulli i zyrtarit të autorizuar për lëshimin e ankesës (ju lutemi shkruani)

**2023/08/15**

Nënshkrimi i zyrtarit të autorizuar

Data (viti/muaji/dita)

**+355699892466**

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)



## Seksioni II. Informacion mbi procedurën

### 1. Numri i referencës së procedurës/Lotit

*Plotësoni numrin e referencës së kontratës në njoftimin e kontratës ose në dokumentet e tenderit.*  
REF-77243-08-10-2023

### 2. Lloji i Procedurës

*Plotësoni llojin e procedurës së përdorur për prokurimin në fjalë.*

Procedurë e hapur <input type="checkbox"/>	<b>Procedurë e hapur e thjeshtuar</b> <input checked="" type="checkbox"/>
Procedurë e kufizuar <input type="checkbox"/>	Procedurë konkurruese me negociim <input type="checkbox"/>
Partneritet për inovacion <input type="checkbox"/>	Dialog konkurrues <input type="checkbox"/>
Procedurë me negociim me shpallje paraprake të njoftimit të kontratës <input type="checkbox"/>	Procedurë me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës <input type="checkbox"/>
Shërbim Konsulence <input type="checkbox"/>	
Kontratë e lidhur pa zhvilluar ndonjë nga procedurat e prokurimit të parashikuara në LPP	

### 3. Autoriteti /Enti Kontraktor

*Emri i autoritetit/entit kontraktor që administron procesin e prokurimit.*

**Spitali Rajonal Vlorë**

### 4. Vlera e përllogaritur e prokurimit

*(Vlera e përllogaritur e kontratës/marrëveshjes kuadër) (shuma në shifra dhe fjalë)*

**3,703,070 (tremilion e shtateqind e tre mijë e shtatedhjete) leke pa TVSH**

### 5. Objekti i kontratës/Marrëveshjes Kuadër

*(Përshkrimi i shkurtër i punëve / mallrave / shërbimeve objekt kontrate/marrëveshje kuader).*

**Loti 2 "Blerje materiale konsumi per laboratorin e Anatomo-patologjise"**

### 6. Afati i fundit për paraqitjen e ofertës

*(Data (viti/muaji/dita)*

**2023/08/21**

7. Data e publikimit të Njoftimit të Fituesit  
(Data (viti muaji dita) nëse është e zbatueshme)

---

8. Data e nënshkrimit të kontratës  
(Data (viti muaji dita) në rastet e kërkesave për pavarshmëri të kontratës)

---

### Seksioni III. Përshkrimi i ankesës

1. Baza ligjore (Shkelje ligjore, bazuar në vendime, akte, dokumente, etj.)

**Hartimi i dokumentave të tenderit është bërë në kundërshtim me Ligjin e Prokurimit Publik dhe Rregullat e Prokurimit Publik.**

#### 2. Objekti i ankesës

- Modifikim i dokumentave të tenderit

X

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës tuaj.

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertës të një/disa operatori/ve ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

(Citoni operatorin/ët ekonomik për të cilin keni pretendime)

- Pavarshmëri kontrate

(Citoni kontratën për të cilën kërkon pavarshmërinë)

- Tjetër

(Citoni këtu objektin e ankesës që nuk përfshihet më sipër)

#### 3. Rrethanat dhe faktet

*Përshkruani rrethanat e faktit.*

**Hartimi i dokumentave të tenderit është bërë në kundërshtim me Ligjin e Prokurimit Publik dhe Rregullat e Prokurimit Publik.**

#### 4. Argumentime mbi shkeljet e pretenduara

*Përshkruani në mënyrë koncize shkeljet e pretenduara, duke argumentuar qartë dhe saktë se përse pretendoni për paligjshmëri në veprimet e autoritetit kontraktor.*

Pasi u njohëm me DT të procedurës së prokurimit me objekt "Loti 2 - Blerje materiale konsumi per laboratorin e Anatomo-patologjise" konstatuam disa kriteret kualifikimi jo të rregullta.

Bazuar në nenin 110 të Ligjit nr. 162/2020 datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenin 97 të V.K.M. nr. 285 datë 19.05.2021 "Për rregullat e prokurimit publik" i ndryshuar po paraqesim këtë formular ankese duke kërkuar modifikimin e kriterëve të kualifikimit.

Në kriteret e veçanta të kualifikimit është parashikuar "2.2.1. Vërtetim nga Dega e Tatimeve për shiron vjetore të realizuar gjate 3 (tre) viteve te fundit financiare (2020, 2021 dhe 2022) ku vlera e tyre te jete jo me e vogel se 40 % e vlerës sëfondit limit te lotit ose shumatores se loteve për të cilat konkurron operatori.

*Shënim\**: Për efekt të përlllogaritjes së vlerës së kërkuar sipas këtij kriteri, vlera mesatare do te aplikohet mbi vlerën e fondit limit të parashikuar sipas sasive të pritshme të lotit/loteve për të cilen ofertohe, konkretisht mbi vlerat e kolonës "Vlera e pritshme e kontratave" ne pikën 2.10.

Nëse operatorët ekonomikë, arrijnë vlerën e xhiros minimale të kërkuar në këto DT, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar, kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur.

Në Nenin 2 "Qëllimi" të ligjit 162/2021 "Për prokurimin publik" parashikohet se:

*Qëllim i këtij ligji është:*

- a) të rrisë eficientën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik...

Ndërsa në Nenin 3 "Parime të përgjithshme" të ligjit 162/2021 "Për prokurimin publik" parashikohet se: 1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

Në Nenin 21 "Autoriteti ose enti kontraktor" të ligjit 162/2021 "Për prokurimin publik" parashikohet se: 1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe jodiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti

*kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurorët e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi...*

Në Nenin 77 "Kërkesat për kualifikim", të ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin public" parashikohet shprehimisht se: *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

*a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*

*bigjendjen ekonomike dhe financiare;*

*c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet.*

*Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës...*

Në nenin 43 të VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, parashikohet se: *1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare .*

*2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:*

*a) dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit mbi kufirin elartë monetar;*

*b) vlerën e përlllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;*

*c) 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit .Shërbim konsulence..*

Kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës së prokurimit. Dokumentat e tenderit dhe kriteret për kualifikim duhet të hartohen në përputhje me LPP-në dhe rregullat e prokurimit publik në mënyrë të tillë që të nxisin pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, si dhe të sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në këto procedura, për realizimin me sukses të kontratës me qëllim zgjerimin e rrethit të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në respekt të nenit 2 të LPPsë.

Sa më sipër kërkojmë që ky kriter të modifikohet duke përcaktuar një vlerë limit të xhiros jo më të madhe së 40% e vlerës së fondit limit pra vlera maksimale të përcaktohet deri në 40%.

Në kriteret e veçanta të kualifikimit është parashikuar "2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga kompania prodhuese ose nga Distributor të Autorizuar nga prodhuesi, për Shqipërinë, për këtë procedurë prokurimi, për tregëtimin e artikujve të ofruar per periudhen që përfshin objektin e prokurimit.

*Shënim: Në rastin e distributorit të autorizuar për Shqipërinë të provohet lidhja me prodhuesin nëpërmjet dokumentacionit përkatës".*

Kërkojmë modifikimin e këtij kriteri kualifikimi si më poshtë vijon:

*"Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga kompania prodhuese ose nga Distributor të Autorizuar nga prodhuesi, për Shqipërinë, për tregëtimin e artikujve të ofruar që përfshin objekti i prokurimit.*

*Shënim: Në rastin e distributorit të autorizuar për Shqipërinë të provohet lidhja me prodhuesin nëpërmjet dokumentacionit përkatës".*

Arsyetimi.

Së pari: Duke qënë se data e hapjes së ofertave është data 21.08.2023, datë kjo që përfshihet në periudhën kur shumica e kompanive prodhuese (në veçanti ato italiane) janë pushim gjithë muajin gusht, operatorët ekonomikë nuk mund të pajisen me një autorizim të tillë të veçantë për këtë procedurë prokurimi. Në këto kushte kufizohet konkurrenca e lirë midis operatorëve ekonomikë.

Së dyti: Autorizimet e prodhuesit lëshohen nga kompanitë prodhuese për të gjitha produktet që ato prodhojnë për një periudhë të caktuar kohore (1 ose 2 vjeçare) dhe një autorizim i tillë është i vlefshëm për të gjitha autoritetet kontraktore shqiptare. Pra kërkesa për një autorizim prodhuesi vetëm për këtë procedurë prokurimi është e tepërt dhe përjashtuese.

Së treti: Periudha që përfshin objektin e prokurimit duhet të hiqet jo vetëm për dy arsyt e mësipërme por edhe sepse koha e fillimit të zbatimit të Marrëveshjes Kuadër është e pacaktuar madje e pacaktueshme pasi varet nga shumë faktorë të tillë si vlerësimi i ofertave, ankimimet e mundshme nga operatorët ekonomikë, kthimet e përgjigjeve, dhënia e vendimit përfundimtar, zbatimi i vendimeve të KPP, njoftimet e fituesit, verifikimi i dokumentacionit të fituesit etj etj.

Në kriteret e veçanta të kualifikimit është parashikuar "2.3.8 Për të gjithë artikujt e ofertuar, duhet të paraqiten mostra deri në ditën e hapjes së ofertave dt 21.08.2023 ora 09:00

*Dorëzimi i kampioneve: mostrave, të bëhe, Spitalit Rajonal Vlore, të mbyllura në një zarf/kuti jo transparente të vulosur mbi të cilin të shenohet:*

*-"Mos e hapni me përjashtim të rasteve kur është i pranishëm Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të procedurës së prokurimit « ..... » dhe jo para dates së hapjes së ofertave*

*-Se bashku me mostrat ofertuesi duhet të japë edhe një shkresë të vulosur dhe firmosur ku të listohen mostrat që ndodhen në zarf/kuti.*

*-Mbi çdo mostër të dorëzuar, ofertuesi duhet të shënoje Nr.Rendor të Artikullit që përfaqëson.*

*Nëse mostrat e dorëzuara, nuk janë të shoqëruara me listën e inventarizimit dhe të identifikuara sipas Nr. Rendor, nëse ka mungesa mostrash për artikuj të veçantë, atëherë oferta do të quhet jo e rregullt dhe rrjedhimisht do të skualifikohet.*

Është e pamundur për OE të sjellin të gjitha mostrat në një kohë aq të shkurtër nisur nga fakti që jemi në muajin gusht kur prodhuesit janë mbyllur për pushime.

Kërkesa për mostrat është e tepërt përderisa në dokumentat e tenderit është kërkuar katalog për cdo artikull që të plotësojë specifikimet teknike "2.3.7 Për të gjithë artikujt e ofruar të paraqiten katalogje, ku të përfshihen edhe specifikimet teknike të hollësishme për secilin artikull (pjesët e katalogut që përmbajnë emërtimin dhe specifikimet e detajuara teknike të artikullit që ofertohet,

*nese nuk jane ne gjuhen shqipe, te perkthehen ne gjuhen shqipe dhe te noterizohen). Operatori ekonomik duhet te markoje ne katalogun perkates produktet qe ofron sipas numrit vendor (te markuara sipas artikullit) te percaktuar ne formularin e ofertes. Katalogjet do pranohen vetem ne forme elektronike nepermjet sistemit elektronik te prokurimit. Per secilin lot".*

Kërkesa për paraqitjen e mostrave 1 orë përpara përfundimit të dorëzimit të ofertave është gjithashtu e kundraligjshme pasi dorëzimi i mostrave bëhet në datën dhe orën kur bëhet dorëzimi i ofertave.

Njësisia e hartimit të dokumentave të tenderit nuk ka argumentuar as teknikisht dhe as ligjërisht këtë kërkesë. Për ne është e qartë se vetëm në këtë mënyrë AK do të kuptoj se sa OE do të marrin pjesë në tender duke i dhënë kohë OE të përzgjedhur që të mund të ndryshojë ofertën në SPE. Kjo është në kundërshtim me Udhëzimin e APP nr. 03 datë 12.04.2022 "Për procesin e administrimit të mostrave të paraqitura nga OE".

Kriteri në lidhje me paraqitjen e mostrave për të gjithë artikujt objekt-prokurimi është sipas parashikimeve të nenit 40, pika 6/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, por nga ana e autoritetit kontraktor nuk është dhënë asnjë argument teknik, se përse kërkohet paraqitja e mostrave sikurse parashikohet në pikën 1 të Udhëzimit të Agjencisë së Prokurimit Publik nr. 03, datë 12.04.2022, "Mbi procesin e administrimit të mostrave të paraqitura nga operatorët ekonomikë" dhe për më tepër ky kriter është një kriter i dubluar dhe që krijon kosto të shtuara për operatorët ekonomikë, pasi në pikën 2.3.7 "Kapaciteti teknik" të Shtojcës 7 të dokumenteve të tenderit, autoriteti kontraktor për të krijuar bindjen se produktet e ofruara nga operatorët ekonomik ofertues do të jenë sipas specifikimeve teknike të dhëna në dokumentet e tenderit, ka përcaktuar që këta ofertues të paraqesin katalogët teknikë për këto artikuj, ku të vërtetohet përputhshmëria e tyre me specifikimet teknike të publikuara, prandaj autoriteti kontraktor duhet të heqë kriterin kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.8 "Kapaciteti teknik" të Shtojcës 7 të dokumenteve të tenderit, pasi nuk e ka argumentuar nga ana teknike vendosjen e këtij kriteri.

Sa më sipër kërkojmë heqjen e kriterit të kualifikimit për paraqitjen e të gjitha mostrave si dhe heqjen e kërkesës për paraqitjen e disa mostrave 1 orë përpara hapjes së ofertave.

Shih Vendimin e KPP nr. 646/2022 datë 12.07.2022 mbi heqjen e kriterit për paraqitjen e mostrave.

Shih Vendimin e KPP nr. 502/2023 datë 21.06.2023 mbi heqjen e kriterit për paraqitjen e mostrave.

Shih Vendimin e KPP nr. 446/2023 datë 31.05.2023 mbi heqjen e kriterit për paraqitjen e mostrave.

Shih Vendimin e KPP nr. 535/2023 datë 29.06.2023 mbi heqjen e kriterit për paraqitjen e mostrave.

Neni 3 ligjit 162/2020 "Për Prokurimin Publik", parashikon se:

"1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

Neni 21 i ligjit 162/2020 "Për prokurimin publik", parashikohen se:

"1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi

dhe në kohë tondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi”.

Neni 36 i ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet se:

“Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet. Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofruesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:

a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofruesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;

b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;

c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës “a”, referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga ljalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga ljalët “ose ekuivalente”.

Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “b” të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofruesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.



Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës "a" të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor."

*Autoritetet kontraktore në hartimin e specifikimeve teknike, krahas përshkrimit të saktë të nevojave të këtij të fundit, duhet të kenë në vëmendje faktin se, hartimi i specifikimeve teknike duhet bërë në një mënyrë gjithëpërfshirëse duke krijuar kushte për konkurrin të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve, duke përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë karakteristikat e mallrave/shërbimeve/punëve dhe në përputhshmëri me objektin e kontratës.*

Urgjënësi ka parashikuar qartësisht në nenin 36 pika 1 paragrafi 4 të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", se *duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik Në respekt të parimit të mësipërm, specifikimet teknike, në asnjë rast nuk duhet të diskriminojnë/përrjashtojnë nga konkurrin operatorët ekonomikë ofertues dhe/ose prodhuesit qofshin këta kombëtar apo ndërkombëtar. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo formë diskriminimi, qoftë ato të dukshme, qoftë ato të fshehta, të cilat kanë të njëjtin efekt. Në asnjë rast, specifikimet teknike nuk duhet të hartohen në mënyrë që të drejtojnë drejt një produkti/malli/shërbimi që ofrohen nga një operator i vetëm ekonomik ose nga një prodhues i vetëm,*

Sa më sipër, autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për procedurën e prokurimit dhe është përgjegjës i tij të përcaktojë kritere që janë në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Rrjedhimisht autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij për të përcaktuar kritere dhe specifikime teknike në lidhje me produktin e kërkuar, por pa përcaktuar kritere të cilat të çojnë drejt një marke të caktuar, apo që nuk ndikojnë në performancën e produktit, pasi përcaktime të tilla janë diskriminuese dhe përrjashtuese nga pjesëmarrja në procedurë të operatorëve ekonomikë të interesuar.

*Në asnjë moment autoriteti kontraktor nuk duhet të vendosë kritere apo të hartojë specifikime teknike të cilat të drejtojnë në një emër të caktuar marke apo prodhuesi, si edhe specifikime teknike të paqarta e konfuze, duke u bërë kështu përrjashtues për operatorë të tjerë për një konkurrencë të hapur e të gjerë, bazuar kjo në përcaktimet e legjislacionit për prokurimin publik si më sipër cituar.*

Bazuar sa më sipër po parashtrajmë vërejtjet dhe sygjërimet tona në lidhje me specifikimet teknike për këtë procedurë prokurimi me qëllim rritjen e konkurrencës së lirë dhe të ndershme midis OE:

Produktet e mëposhtme:

1	Kontenitor biopsie me formaldeide	4% 10 ml
2	Kontenitor për biopsi	150 ml

janë prodhime të kompanisë Kaltek srl e cila ka një distributor zyrtar në R.SH.

Kërkojmë që për:

- produktin nr. 1 specifikimi 10 ml të ndryshohet në 10-15 ml (hapet diapazoni).
- produktin nr. 2 specifikimi 150 ml të ndryshohet në 120-150 ml (hapet diapazoni).

Specifikimet e propozuara nuk e zvogëlojnë cilësinë e artikujve të prokurimit në asnjë mënyrë, por mundësojnë pjesëmarrje më të madhe të ofertuesit në tender.

5. Kërkesë për ekspertizë të posaçme

Po

Jo

(Nëse po, specifikoni llojin e ekspertizës që kërkon)

6. Kërkesë për përjashtim të zyrtarëve që do të merren me shqyrtimin e ankesës:

7. Lista e informacionit konfidencial:

*Përcaktoni se cili informacion është konfidencial, nëse ka. Shpjegoni pse informacioni është ose një version i dokumenteve përkatëse me heqjen e pjesëve konfidenciale dhe një përmbledhje të përmbajtjes.*

**Kujdes: Ankimesi duhet t'i bashkëlidhë ankimit, që do të paraqesë në autoritetin/ entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik, dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën pranë Komisionit të Prokurimit Publik**

Dërgojeni formularin e plotësuar të ankesës së prokurimit, të gjitha shtojcat e nevojshme dhe kopjet shtesë, pranë **Autoritetit /Enti Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.**

Shënim: Ankimesi duhet ta dërgojë njëkohësisht ankesën në autoritetin/ entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit publik

Nr. i faksit:

**E-mail: ceo.dmdgroup@gmail.com**

Nënshkrimi dhe vula e Ankuesit

Administratori

Matteo SHEDU

